



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Prishtinë, më 28 korrik 2022
Vendimi nr. 27/22

Duke u bazuar në nenet 15,17,18,19,20 dhe 28 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-226 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 28.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve KA Healthcare BV (*blerës*) dhe Univers ALB S.A.R.L (*shitës*), mbi Balkan Alliance Healthcare BV.

KA Healthcare BV është shoqëri private holandeze me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresë në Strawinskylaan 1431, 1077XX Amsterdam, Holandë dhe me nr. të regjistrimit tregtar Holandez 85534587, përfaqësuar nga Dutch Trust Management B.V, përfaqësuar nga z. Nikita Vinogradov (drejtor i autorizuar). KA Healthcare BV është shoqëri holding, pa aktivitete, e cila zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera. KA Healthcare BV nuk ka asnjë degë apo qe zotëron ndonjë shoqëri në Kosovë.

Univers-ALB S.A.R.L është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me seli në Rue Michel Rodange, 18, L-2430 Luksemburg dhe i regjistruar në Regjistrin Tregtisë dhe Shoqërive të Luksemburgut me nr. B138174.

Univers-ALB është shoqëri holding, pa aktivitete e cila zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera, nga të cilat është edhe në Balkan Alliance Healthcare BV, në të cilën Universal-ALB është ortak mazhoritar dhe zotëron 86.33% të kapitalit të shoqërisë.

Univers-ALB është shoqëri holding, pa aktivitete e cila zotëron pjesëmarrje në shoqëri të tjera, nga të cilat është edhe në Balkan Alliance Healthcare BV, në të cilën Universal-ALB është ortak mazhoritar dhe zotëron 86.33% të kapitalit të shoqërisë.

Balkan Alliance Healthcare BV është shoqëri private holandeze me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Amsterdam, Holandë dhe adresë në Basisweg 10,1043 AP, Amsterdam, Holand dhe nr. i regjistrimit tregtar Holandez 85534587. Balkan Alliance Healthcare BV zotëron 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë shqiptare American Hospital sh.a me NUIS K61821002C.

Z. Klodian Allajbeu, i lindur me 21 prill 1978 në Berat, Shqipëri, me pasaportë nr. B03724859, është ortak minoritar i shoqërisë dhe ka në pronësi 13.67% të kapitalit të shoqërisë që do t'i bartë tek kompania KA Healthcare BV.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 € (*njëqind euro*) dhe për Autorizim për Realizimin e Përqendrimit në vlerë prej 3,000.00 € (*tre mijë euro*).

Arsyetim

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 17.06.2022 ka pranuar kërkesë, me numër të protokollit 171/22-01/H, lidhur me njoftimin për realizimin e përqendrim përmes parashtruesit të kërkesës nga përfaqësuesi më autorizim znj. Mrika Gashi, me nr. personal 1172058503, adresa rr. "Fehmi Agani", H 79, K.1, Prishtinë, për përqendrim të ndërmarrjeve KA Healthcare BV (blerës) dhe Univers-ALB S.A.R.L (shitës), mbi Balkan Alliance Healthcare BV (targeti), të realizuara përmes shitjes dhe transferimit të 100% të aksioneve. Kërkesa për përqendrim është e bazuar në Marrëveshjen për Shitblerjen e Aksionëve të lidhur me datë 06.06.2022, me të cilën KA Healthcare BV do të fitoj 100% të aksioneve që palët tjera pjesëmarrëse në përqendrim Univers-ALB S.A.R.L dhe z. Klodian Allajbeu, zotërojnë në shoqërinë Balkan Alliance Healthcare BV.

Kërkesa për përqendrim në Republikën e Kosovës është bërë për arsye se American Hospital Kosova sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, më seli në adresë rr. "Shkupi", nr. 25, Prishtinë, Republika e Kosovës dhe me nr. identifikues 810812158, me pronar dhe themelues American Hospital sh.a – Shqipëri. American Hospital Kosova sh.p.k është themeluar në vitin 2012. Balkan Alliance, është prezent në Kosovë përmes filialit American Hospital Kosova sh.p.k. American Hospital Kosova sh.p.k ofron të gjitha shërbimet diagnostike dhe ndërhyrjet kirurgjikale. American Hospital sh.a është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve shqiptare në datën 17.02.2006 me NUIS K61821002C, i cili është i aset i Balkan Alliance Healthcare BV, veprimtari e së cilës është tregu i shërbimeve spitalore.

Internacional Hospital SH.A, me adresë autostrada Tiranë – Durrës, km 01, Fushë – Mezez, Tiranë, Republika e Shqipërisë. Në Shqipëri pjesa e tregut që zënë dy asetet e Shqipërisë, AH dhe IH mbeten në total 12%.

Procedurat e ndjekura:

- a) Vlerësimi i lëndës/dokumentacionit
- b) Njoftimit për realizimin e përqendrimit në ueb faqen e AKK-së, me datë 28.06.2022
- c) Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 29.06.2022
- ç) Dokumentacioni i nevojshëm për qëllimin e njoftimit të Përqendrimit.

Kërkesa për Përqendrim është e bazuar në Marrëveshjen për blerje të aksioneve, të lidhur me datë 06.06.2022 më të cilën KA Healthcare BV do të fitoj 100% të aksioneve që palët tjera pjesëmarrëse në përqendrim, Univers-ALB S.A.R.L, dhe z. Klodian Allajbeu, zotërojnë në shoqërinë Balkan Alliance Healthcare BV, (BAH).

Andaj, në bazë të kërkesës Sekretariati i Autoritetit ka bërë vlerësimin e Kërkesës për Përqendrim.

Baza juridike:

Sipas nenit 15 të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-226 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën e kalon shumë 20 milion euro.
- Kompania Balkan Alliance Healthcare BV zotëron 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë shqiptare American Hospital sh.a.

Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu Relevant: Struktura e spitalit American Hospital Kosova SH.P.K në Republikën e Kosovës nuk ndryshon.

Tregu i produktit – Shërbime spitalore.

Tregu gjeografik – është Shqipëria, ndërsa në shtrirje kombëtare definohet si tregu i Republikës së Kosovës pasi që operon American Hospital Kosova sh.p.k.

Tregjet e Prekura

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që blerësi nuk ka asnjë degë apo ndonjë shoqëri në Republikën e Kosovës, andaj transaksioni dhe konkurrenca në këtë treg nuk ndryshon d.m.th. në tregun e shërbimeve spitalore. Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte negative në Republikë e Kosovës në lidhje me konkurrencën në tregun përkatës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Holandës, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se njëra nga palët (targeti) ka degë të regjistruar në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, sepse pala blerëse nuk është prezente në Republikën e Kosovës dhe ndërmarrjet e përfshira në përqendrim nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar që transaksioni nuk paraqet efekte negative në konkurrencë për arsye se ky transaksion/blerje nuk ndikon në

forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët andaj, duke u bazuar në Ligji 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës ka përdorur procedurën e shkurtë.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva

KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi

Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdatuaj
Anëtare

